

STATUTI
I
I SHOQËRISË ME PERGJEGJËSI TE KUFIZUAR
“ ERI AGRO” Sh.P.K

Ne Fier sot ne date 18.11.2019, ne bazë te ligjit 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Per Qëndren Kombetare te Regjistrimit” I ndryshuar , ne te nënshkruarit shpallim si me poshtë vijon:

FORMIMI I SHOQËRISË

Neni 1

Formohet shoqëria e quajtur “ **ERI AGRO** ” **Sh.P.K** (qe me poshtë do te quhet “Shoqëria”) me ortakë:

ARLIND HAZIZI atesia Teki , lindur me 18.07.1989 ne Strum Fier dhe banues ne Strum Fier me shtetesi shqiptare, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar me pashaporte biometrike me nr. BR3965146 dhe nr. personal I90718031T,

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Strum Fier ” rruga nacionale “ Fier – Berat ” ,Zona kadastrale 3532 , km 18 Pasuria nr. 12/28 . Gjatë ushtrimit te aktivitetit të saj Shoqëria mund të hapë degë apo zyra përfaqësimi kudo në territorin e Republikës se Shqipërisë.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë eshte e pakufizuar dhe fillon që prej datës se regjistrimit te saj ne Qëndrën Kombëtare te Biznesit (QKB) dhe marrjes se liçensave përkatëse.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si me poshtë:

Prodhim dhe tregetim te produkteve bujqesore
Ky aktivitet do te ushtrohet pas marjes se Liçences perkatëse

Neni 5

Kjo shoqëri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6,7

Kapitali themeltar i shoqërisë eshte 100,000 leke. Shoqëria mund te shtoje ose zvogeloje kapitalin e saj sipas vendimit te ortakut te vetem.

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100,000 lekë dhe i perbere nga (nje) kuote dhe do te ngurtesohet ne banke pasi shoqëria te jete regjistruar ne QKB.

Çdo ortak ka të drejtën e votës.

Kontributi i ortakëve në kapitalin themeltar eshte si me poshtë:

Arlind Hazizi 100 % te vleres se kuotave ne kapitalin themeltar, ose 1 kuote te barabarte me vlere prej 100,000 leke ne kapitalin themeltar.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8



Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 9

Ortaket e shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund ta terheqin. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci i shoqerise per fitimin e realizuar.

Neni 10

Kuotat e ç' do anetari perputhen me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqerise. Kuotat e tij anetari i shoqerise mund t'ua ofroje te tretteve. Anetaret e shoqerise kane perparesi per blerjen e kuotave perpara personave te trete jashte shoqerise. Ortaku qe deshiron te transferoje ose te shese kuotat e tij i drejton nje kerkese me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe te jete i njejte me ate qe do t'i ofrohet dhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e blesesit. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene. Edhe e drejta e perparesise per nenshkrimin e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e perparesise per nenshkrimin e kuotave eshte ne proporcion me kuotat qe zoteron secili prej ortakeve ne kete shoqeri. Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh dhe ne rast se ortakët do ti blejne keto kuota, i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij vendimin e ortakeve te tjere per te blere te gjithë ose pjeserisht kuotat e tij. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet te behen me akte noteriale dhe nje kopje e ketij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve.

Neni 11

Emertimi i shoqerise tregtare, forma ligjore e shoqerise, numri unik i identifikimit, vendndodhja e shoqerise, emri i administratorit, duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri, nepermjet perdorimit te letres apo mjeteve elektronike, dhe qe ju drejtohen te tretteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 12

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejttat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te tretteve pa asnje kufizim.

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve.
- 2- Administratori.
3. Drejtuesi Teknik

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 13

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve e cila mund te thirret nga çdo anetar i shoqerise qe perfaqeson te pakten 5% te kapitalit te shoqerise. Antaret duhet te njoftohen me shkrese ose nepermjet postes elektronike, jo me vonë se 7 dite perpara dhe ne lajmerim duhet te jete shkruar vendi, ora dhe ceshtjet e rendit te dites qe do te trajtohen ne mbledhje.

Neqoftese Asambleja nuk eshte mbledhur sipas rregullave te caktuara ajo mund te marre vendim kur çdo anetar i shoqerise eshte prezent dhe jane dakort te marrin vendime pavaresisht parregullsise.

TE DREJTAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE

Neni 14

Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

- 1) Asambleja e Zakonshme:

Mblidhet te pakten 1 here ne vit, dhe sa here eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

Kompetencat e Asamblese se Zakonshme:



Asambleja e Zakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhteme:

- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetence te Asamblese.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Vendos edhe per cdo ceshtje tjeter qe nuk sjell ndryshime ne statutin e shoqerise ose nuk eshte lene ne kompetence te Asamblese se Jashtezakonshme

2) Asambleja e Jashtezakonshme:

Ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme vendimet do te jene te vlefshme ne rast se ato do te merren nga ortaket qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar.

Asambleja e Jashtezakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhtme:

- Te marre ne shqyrtim dhe ka te drejte te miratoje te gjitha ndryshimet e statudit.
- Ben transferimin e kuotave te te tretet.
- Realizon blerjen, shitjen dhe transferimin e pasurive te paluajtshme te shoqerise etj. dhe vendos ne lidhje me keto ceshtje;
- Vendos ne lidhje me çdo çeshtje te lidhur me pasurine e shoqerise, marrje hua, vendosje hipoteke, barre siguruese etj .
- Vendos per pjesemarrjen ne shoqeri te tjera per hapje dege, filiale, zyra perfaqesimi etj .
- Si dhe çdo çeshtje tjeter qe nuk eshte ne kompetencen e Asamblese se Zakonshme.

Neni 15

Vendimet e asamblese se jashtezakonshme te Ortakeve te cilat jane marre ne nje mbledhje te thirrur ne menyre te rregullt dhe konform kontrates se themelimit, Statutit e te ligjeve jane te detyrueshme per te gjithë ortaket e tjere, edhe per ata qe nuk kane diskutuar ose nuk kane qene dakord.

Cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter qe nuk eshte administrator. Asnje i derguar nuk mund te perfaqesojë me shume se nje ortak.

Ne Asamblene e Ortakeve marrin pjese nese eshte e nevojshme per te dhene mendim eksperte, revizore etj.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak ose nga nje person tjeter me prokure te posacme.

Neni 16

Marrja e vendimeve te Asamblese, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

ADMINISTRIMI

Neni 17

Shoqeria administrohet nga administratori i cili caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe 5 vjecare. Ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin qe i eshte shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem edhe nga specialistet perkates. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise ua jep shprehimisht ortakeve.

Administrator i shoqerise eshte: **z. ARLIND HAZIZI** atesia Teki , lindur me 18.07.1989 ne Strum Fier dhe banues ne Strum Fier me shtetesi shqiptare, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar me pashaporte biometrike me nr. BR3965146 dhe nr. personal I90718031T, zgjedhur per një periudhe 5 vjecare me te drejtë ripërsëritje..

Neni 18

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakeve.

Neni 18/1

Administratori ka te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme per furnizime publike private, te ndermarri veprime

gjyqesore per dhe ne emer te shoqerise, etj. Administratori mund te jape prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh. Perfaqesimi ligjor i shoqerise eshte i vlefshem per cdo veprim gjyqesor apo jashtegjyqesor.

Administratori eshte i detyruar te mbaje konform ligjit te gjitha rregjistrat e domosdoshme per aktivitetin e shoqerise. Administratori i shoqerise eshte i detyruar te mbaje inventare te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me parjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Administratori eshte pergjegjes per administrimin e shoqerise dhe informon ortaket per ecurine e veprimtarise tregtare te shoqerise. Gjate veprimtarise se tij ai vepron duke marre parasysh interesat e shoqerise, duke zbatuar parimet e detyrimit te besnikerise.

MARRREDHENIET E PUNES

Neni 20

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 21

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i kesaj shoqerie.

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Neni 22

Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit, veprimtarine e tij si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje ekspertit ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE

Neni 23

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

Neni 24

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve per mundesine e prishjes se shoqerise.

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 25

Ne rast se shoqeria prishet per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c' regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

LIBRAT E SHOQËRISË

Neni 26

Po kështu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtem

- 1) Libri i Ortakëve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve të organit administrativ
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve të eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mësipërm duhet të jenë të ruajtura për 10 vjet e çdo faqe duhet të jetë e vëlosur.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 27

Përsa është shprehur në këtë statut i referohemi ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe rregullores së brendshme të shoqërisë. Çdo ndryshim bëhet në të njëjtën mënyrë siç është nxjerrë ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

Ky statut nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË

"ERI AGRO" Sh.P.K

ARLIND HAZI

